## Titulli i lëndës: BARRIERAT ARKITEKTONIKE

| Informatat themelore për lëndën | |
|---|---|
| **Njësia akademike:** | Fakulteti i Arkitekturës |
| **Titulli i lëndës:** | BARRIERAT ARKITEKTONIKE |
| **Niveli:** | MA |
| **Statusi i lëndës:** | ZGJEDHORE |
| **Viti i studimeve:** | 1/SEM 1 |
| **Numri i orëve në javë:** | 2+0 |
| **Kreditë ECTS:** | 3 |
| **Koha / Vendi:** | Sipas orarit të shpallur |
| **Mësimdhënësi:** | Prof. Ass. Dr. Rozafa Basha, |
| **Të dhënat kontaktuese:** | Rozafa.basha@uni-pr.edu |
| | |
| **Përshkrimi i lëndës:** | Në një shoqëri në rritje dhe plakje, ku nevoja për zgjidhje të qëndrueshme (si ato sociale dhe mjedisore) është kritike, përqasjet projektuese gjithëpërfshirëse (sikurse Dizajni Universal) janë pranuar globalisht si një mjet për të përmbushur nevojat ekzistuese dhe të ardhshme të individëve dhe grupeve. *Dizajni Universal* është një mënyrë mendimi, që kërkon nga projektuesi të marrë në konsideratë pasojat e dizajnit dhe t'i vendosë nevojat e të gjithë njerëzve në zemër të procesit.<br>Pjesa teorike dhe praktike e modulit do t'i njoftojë studentët me nocionet e barrierave arkitektonike dhe qasjen në mjedisin e ndërtuar. Kursi gjithashtu do të prezantojë përqasjet e dizajnimit gjithëpërfshirës për krijimin e mjedisit pa barriera. Do të diskutohet edhe filozofia e Dizajnit Universal bashkë me çështjet ndërlidhëse sociale, ekonomike, legjislative, etj. si dhe do të prezantohen zhvillimet më të fundit në këto fusha. |
| **Qëllimet e lëndës:** | Qëllimi i kursit është që t'i njoftojë studentët me nocionet e barrierave arkitektonike, qasjen në mjedisin e ndërtuar dhe përqasjet dizajnuese gjithëpërfshirëse për krijimin e mjedisit të ndërtuar pa barriera. |
| **Rezultatet e pritshme të nxënies:** | - Vlerëson nivelin e qasshmërisë fizike të komponenteve të ndryshme arkitekturale në mjedisin e ndërtuar<br>- Projekton mjedise të qasshme për persona me aftësi të kufizuara duke i zbatuar normat ligjore dhe praktikat e mira të Dizajnit Universal dhe Dizajnit për të Gjithë, në projekte konkrete arkitektonike;<br>- Planifikon interventimet përmirësuese në mjedise të paqasshme duke zbatuar normat dhe kërkesat ligjore për mjedisin e ndërtuar pa barriera;<br>- Analizon problemet e qasshmërisë së personave me aftësi të kufizuara në mjedisin e ndërtuar në kontekst hapësinor, ligjor dhe socio-kuturor; |

| | |
|---|---|
| | - Ndërton strategji për eliminimin e barrierave arkitektonike në mjedisin e ndërtuar duke u bazuar në analizat nga perspektiva hapësinore, ligjore dhe socio-ekonomike |

| **Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)** | | | |
|---|---|---|---|
| **Aktiviteti** | **Orë mësimore** | **Ditë/Javë** | **Gjithsej** |
| Ligjëratat | 2 | 15 | 30 |
| Teori/Punë në laborator/Ushtrime | | | |
| Punë praktike | | | |
| Përgatitje për test intermediar | | | |
| Konsultime me mësimdhënësin | | | |
| Puna në terren | | | |
| Testi, punimi seminarik | 2 | 4 | 8 |
| Detyrë shtëpie | 2 | 8 | 16 |
| Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi) | 2 | 8 | 16 |
| Përgatitja për provimin final | 2 | 6 | 12 |
| Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final) | 1 | 3 | 3 |
| Projektet, prezantimet, etj. | 1 | 2 | 2 |
| **Total** | | | **87~ 3 ECTS** |

| | |
|---|---|
| **Metodat e mësimdhënies:** | Ligjërata, punëtori të shkurtra projektuese, vizita në terren dhe diskutime seminarike. Disa moduj të këtij kursi do të përfshijnë diskutimet interaktive dhe metodat e mësimit problemor. |
| **Metodat e vlerësimit:** | - Pjesëmarrja e rregullt në ligjërata dhe ushtrime - 5%;<br>- Vlerësimi i punimit seminari/ projekti - 45%;<br>- Vlerësimi intermediar/ prezantimi leximeve seminarike - 35%;<br>- Prezantimi seminarit/ projektit (shkathtësia e prezantimit) 10%;<br>- Diskutimet dhe aktivitetet e ngjashme 5% |
| | |
| **Literatura primare:** | 1. R. Basha, Hapësira publike për të gjithë – konceptet e teorike, Multimedia, 2021<br>2. P. Meuser, Construction and Design Manual, Accessibility and Wayfinding, DOM Publishers, 2019<br>3. J. Boys, Doing Disability Differently, An Alternative Handbook on Architecture, dis/ability and designing for everyday life, Routledge, 2014<br>4. E. Steinfeld, J. Maisel., Universal Design: Creating Inclusive Enviroments, Wiley, 2012<br>5. W. Presier, K. Smith, Universal Design Handbook, Mc Graw Hill,2010 |
| **Literatura shtesë:** | 1. C. Lebbon, J. Clarkson, R. Coleman & S. Keates, Inclusive Design: Design for the Whole Population, Springer Verlag, 2003<br>2. Imrie R., Accessible Housing: Quality, Disability and Design, Routledge, 2005<br>3. E. Burton, L. Mitchel, Inclusive Urban Design, Street for Life, Routledge, 2006<br>4. C. Greed, Inclusive Urban Design, Public Toilets, Routledge, 2003<br>5. Keates S. L., Clarkson J., Countering Design Exclusion: An Introduction to Inclusive Design, Springer Verlag, 2004 |

| Hartimi i planit mësimor | |
|---|---|
| **Java** | **Titulli i ligjëratës** |
| ***Java 1:*** | Hyrje në lëmin e projektimit arkitektonik pa barriera dhe njohja me nocionin e qasjes për P.A.K. |
| ***Java 2:*** | Barrierat arkitektonike – konceptet dhe përkufizimet themelore |
| ***Java 3*:** | Kuadri normativ - teknik dhe ndërtimor (U.A. 33/2007) |
| ***Java 4:*** | Barrierat (tipologjitë) në mjedis të ndërtuar |
| ***Java 5:*** | Planifikimi për mjedis pa barriera |
| ***Java 6*:** | Prezantim i projekteve që zbatojnë në mënyrë inovative qasjen apo ligjëratë vizituese |
| ***Java 7:*** | Prezantim i projekteve që zbatojnë në mënyrë inovative qasjen ose ligjëratë vizituese |
| ***Java 8:*** | Vlerësimi intermediar 1 – prezantimi dhe diskutimi i leximeve seminarike |
| ***Java 9:*** | Kriteret për projektimin për qasje, vizitueshmëri dhe adaptabilitet për tipologji të ndryshme të ndërtesave – ndërtesa dhe hapësirat e hapura publike |
| ***Java 10:*** | Parimet e dizajnit universal si strategji projektimi të një mjedisi të ndërtuar pa barriera |
| ***Java 11*:** | Metodat e vlerësimit i qasjes në ndërtesa dhe hapësira publike – ADA Checklist |
| ***Java 12*:** | Metodat e vlerësimit i qasjes në ndërtesa dhe hapësira publike – qasja absolute dhe relative (diskutimi i mesëm i detyrës kryesore, seminarit/ projektit) |
| ***Java 13*:** | Diskutimi i rasteve studimore |
| ***Java 14*:** | Diskutimi i rasteve studimore |
| ***Java 15*:** | Vlerësimi intermediar 2 (prezantimi i projektit a seminarit përfundimtar) |

**Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes**

*Rregullat e mirësjelljes:*

- *Vijimi i rregullt i ligjëratave dhe ushtrimeve është i obligueshëm. Me më shumë se 3 mungesa të arsyeshme apo të paarsyeshme, studentit nuk i lejohet vazhdimi i lëndës në vitin përkatës akademik dhe detyrohet që ta përsëris lëndën në vitin e ardhshëm akademik.*
- *Mbajtja e qetësisë në mësim*
- *Ndalja e telefonave celularë*
- *Hyrja në sallë të mësimit me kohë*

*Vërejtje: Profesorja e lëndës e rezervon të drejtën e modifikimit të radhitjes së ligjëratave apo aktiviteteve mësimore (të heq apo shtojë temë) në funksion të konkretizimit të qëllimit të lëndës.*